

Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës Komora inženjera Republike Kosovo Chamber of Engineers of the Republic of Kosovo	
Njësia org. Org. Jednica Org. Unit	Nr. i Prot. Broj Prot. Prot. No.
Nr. i Faqes Br. Stranica Nr. Pages	Data: Datum: Date:
PRISHTINË / A No.1	

OIRK  
305/25  
30.06.25



**ODA E INXHINIERËVE  
TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

Nr. 32-BD/2025  
Prishtinë: 24.06.2025

Bordi Drejtues i ODËS SË INXHINIERËVE NË FUSHËN E NDËRTIMIT me nr. Fiskal 603383324, në mbështetje të nenit 17, paragrafi 5, nën paragrafi 5.13 të LIGJIT NR. 08/L – 012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit, në mbështetje të nenit 24, paragrafi 1, nënparagrafi 1.20 të STATUTIT TË ODËS SË INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR PERIUdhËN E PËRKOshHME, i miratuar më datën 31.12.2024, me nr. Të protokollit 8648/24, dhe në mbështetje të nenit 7 të Rregullores për Edukimin e Vazhdueshëm Profesional të Inxhinierëve të Licencuar, e miratuar më datën 31.12.2024, me nr. Të protokollit 8655/24, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datën 24.06.2025, nxjerr këtë:

**VENDIM**

1. Miratohet **oferta e trajnerit Rinor Hoxha** për organizimin e **trajnitimit me temën "Statuti dhe Rregulloret e Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës"**, i cili do të zhvillohet në **katër (4) termine të ndryshme**, për të mundësuar pjesëmarrjen e anëtarëve të OIRK-së. Formati i formularëve: a) lista e aplikimit, b) kontrata, c) kërkesa dhe g) forma e kartelës i janë bashkangjitur këtij vendimi.
2. Trajnimi do të zhvillohet online përmes platformës **Microsoft Teams**, në terminet si vijon:

Termi i parë: 28 Qershor 2025, ora 09:00 – 12:00

Termi i dytë: 28 Qershor 2025, ora 13:00 – 16:00

Termi i tretë: 30 Qershor 2025, ora 16:00 – 19:00

Termi i katërt: 01 Korrik 2025, ora 16:00 – 19:00


3. Kohëzgjatja e secilit term është 3 orë, dhe pjesëmarrësit e trajnitimit do të përfitojnë dy (2) pikë kredituese, sipas Vendimit Nr. 28-BD/2025 të Bordit Drejtues.
4. Shuma totale për përgatitjen dhe realizimin e trajnitimit në këto katër termine është **1,250 € (njëmijë e dyqind e pesëdhjetë euro)**.
5. Autorizohet Kryetari i OIRK-së dhe administrata për finalizimin e procedurave kontraktuale dhe organizative për realizimin e trajnitimit.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

Vendimi i dërgohet:







- Komisionit Mbikqyrës.
- Bordit Drejtues të OIRK-së
- Arkivit të OIRK-së.



**ODA E INXHINIERËVE  
TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**



Bordi Drejtues i OIRK-së:

1. **Arsim Rapuca**  
Kryetar i OIRK-së 
2. **Mimoza Shahini**  
Anëtare e Bordit Drejtues të OIRK-së \_\_\_\_\_
3. **Kadri Morina**  
Anëtarë i Bordit Drejtues të OIRK-së 
4. **Afrim Demiri**  
Anëtarë i Bordit Drejtues të OIRK-së 
5. **Nebi Pllana**  
Anëtarë i Bordit Drejtues të OIRK-së 
6. **Bujar Jupaj**  
Anëtare e Bordit Drejtues të OIRK-së 
7. **Sami Kolgeci**  
Anëtarë i Bordit Drejtues të OIRK-së 

**OFERTË PËR ORGANIZIMIN E TRAJNIMEVE**  
**“Statuti dhe Rregulloret e Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës”**

**I. Përmbajtja e trajnimit**

Ligji nr. 08/L-012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në fushën e ndërtimit është miratuar dhe ka hyrë në fuqi në muajin Janar të vitit 2022. Ky Ligj ka paraparë themelimin e Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Oda) si një Odë e cila përbëhet nga inxhinierët e licencuar në fushën e ndërtimit. Konstituimi i Odës është bërë me datë 21 dhjetor 2024 në mbledhjen e Kuvendit të Anëtarëve me të cilin rast është miratuar Statuti i Odës dhe rregulloret përkatëse që përcaktojnë aspektet organizative të Odës dhe të drejtat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të Odës. Në mbledhjen e Kuvendit të Anëtarëve janë zgjedhur gjithashtu organet e Odës me të cilin rast Oda është funksionalizuar dhe ka filluar të ushtrojë kompetencat e veta përkatëse ligjore.

Në procesin e parë të licencimit të inxhinierëve nga MMPHI<sup>1</sup> janë licencuar gjithsej 910 inxhinierë të ndërtimit, të cilët kanë shërbyer si anëtarët themelues të Odës. Pas konstituimit të organeve të Odës, procesi i licensimit është duke u zhvilluar nga Komisioni vlerësues për licensim në kuadër të Bordit Drejtues të Odës. Si rrjedhojë, numri i anëtarëve të licencuar të Odës është duke u rritur në vazhdimësi, ku pritet të ketë edhe aplikime të reja nga inxhinierët për licensim dhe anëtarësim në Odë.

Për deri sa Oda është një organ i ri, trajnimi i anëtarëve të Odës lidhur me aspektet organizative të Odës dhe të drejtat dhe përgjegjësitë që ata i kanë si anëtarë të Odës është tejet i rëndësishëm, në mënyrë që Oda të ushtroj **kompetencat e veta ligjore** si dhe të sigurohet **efikasitet i punës së organeve të Odës** por dhe **anëtarësi aktive** me përfshirjen e tyre në procedura të ndryshme përkatëse lidhur me Odën.

Si rrjedhojë **trajnimi i propozuar do të trajtoj temat** në vijim, në përputhje me Statutin dhe Rregulloret e miratuara të Odës:

- Kompetencat e Odës dhe struktura organizative e Odës (*Kuvendi i Odës, Komisioni Mbikëqyrës, Kryetari i Odës, Bordi Drejtues, Komisioni Disiplinor, Komisioni i Ankesave dhe Drejtori Ekzekutiv, si dhe Administrata e Odës*)
- Procesi i licensimit, ri-licencimit dhe llojeve të anëtarësisë në Odë, duke përfshirë njoftimin me sistemin elektronik të Odës që është duke u përgatitur
- Të drejtat dhe detyrimet e anëtarëve të rregullt të Odës
- Roli i Odës në përfaqësimin dhe mbrojtjen e anëtarëve nga Oda

---

<sup>1</sup> Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

- Detyrimet e anëtarëve të Odës për zbatimin e standardeve etike dhe të sjelljes profesionale
- Përgjegjësia profesionale dhe disiplinore e anëtarëve të Odës, shkeljet e rënda dhe të lehta disiplinore, njoftimi dhe procedurat për shkelje disiplinore
- Edukimi i vazhdueshëm profesional, duke përfshirë programin 1 vjeçar të trajnimeve, trajnimet profesionale dhe ato tekniko-rregullative si dhe mundësia e njohjes nga Oda të trajnimeve të mbajtura jashtë vendit nga anëtarët e Odës
- Taksat dhe tarifat e zbatueshme të Odës si dhe format e pagesës
- Sigurimi i përgjegjësisë profesionale për anëtarët e Odës, shuma e mbulimit dhe procedura
- Funksionimi i administratës së Odës dhe mbajtja si dhe publikimi i regjistrave të Odës
- Mundësitë për pezullimin dhe revokimin e licencës së inxhinierit nga Oda
- Kriteret dhe procedura e njohjes së licencave profesionale të inxhinierëve të lëshuara jashtë vendit, dhe
- Regjistrimi i inxhinierëve praktikantëve në Odë, të drejtat dhe detyrimet e tyre.

Ky trajnim është pjesë e sistemit të Edukimit të Vazhdueshëm Profesional të përcaktuar me Rregulloren përkatëse dhe për të njëjtin mund të përcaktohen deri në tre (3) pikë kredituese për anëtarët e Odës, sipas Vendimit të Bordit Drejtues të Odës.

## **II. Forma e trajnimit, kohëzgjatja dhe kalendari**

Duke pasur parasysh numrin e anëtarëve të Odës (mbi 1,000) që do të ndjekin këtë trajnim, forma më e mirë e organizimit të trajnimit është **online** (në kohë reale) përmes platformës **Microsoft Teams**. Trajnimi do të përfshijë:

- prezantimin nga trajneri në power point të temave të cekura në pikën I,
- pyetje për anëtarët e Odës për të vlerësuar mendimet e tyre përmes platformës Menti, dhe
- sesion të pyetjeve dhe përgjigjeve me trajnerin qoftë përmes Chat Room në kuadër të Teams apo edhe pyetjeve të drejtpërdrejta përmes mikrofonit.

Për të siguruar efikasitet në trajnim, propozimi është që numri i pjesëmarrësve për një trajnim të limitohet në **treqind (300)**. Si rrjedhojë, në mënyrë që t'i ofrohet qasje në trajnim të gjithë anëtarëve, duhet të organizohen gjithsej **katër (4) trajnime**, ku anëtarët do të kenë mundësinë të zgjedhin datën më të përshtatshme.

Trajnimi do të zgjas gjithsej **tre (3) orë**, me pauzë pesëmbëdhjetë (15) minutëshe ndërmjet. Për të siguruar pjesëmarrje sa më të madhe dhe mundësi që inxhinierët të aranzhojnë pjesëmarrjen me angazhimet e tyre primare profesionale, trajnimi do të mbahet **ditëve të Shtuna nga ora 10:00 deri në 13:00**.

Datat e propozuara të trajnimeve janë: **14 Qershor, 28 Qershor, 6 Shtator dhe 13 Shtator 2025.**

Të gjitha materialet e trajnimit do të ndahen me pjesëmarrësit në trajnim pas përfundimit të trajnimit.

### III. Oferta financiare:

Përgatitja e materialeve të trajnimit dhe mbajtja e katër (4) trajnimeve gjatë vitit 2025	1250 €
---	--------

R. Hoxha

### IV. Për trajnerin

Rinor Hoxha është jurist dhe ekspert me përvojë mbi dhjetë (10) vjeçare në mbështetje të zhvillimit të politikave dhe ligjeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Ai ka qenë ekspert kyç i iniciativave të rëndësishme qeveritare si metodologjia për zhvillimin e Koncept Dokumenteve, përgatitja dhe monitorimi i Strategjisë së parë të Kosovës për Sundimin e Ligjit 2021-2026 dhe trajner për zbatimin e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative për më shumë se pesë (5) vite. Viteve të fundit ka qenë i angazhuar gjithashtu si trajner përmes organizatës gjermane "GIZ" dhe Institutit të Kosovës për Administratë Publike, për nivelin qendror dhe lokal për zbatimin e programit për parandalimin dhe zvogëlimin e barrës administrative. Rinori është trajnues i certifikuar nga Instituti i lartpërmendur.

Specializim i tij pra përfshin procedurat administrative dhe aspektet organizative të agjencive publike. Si pjesë e kësaj, Rinori ka mbështetur gjithashtu Komisionin e MMPHI për Themelimin e Odave në përgatitjen e Statutit të Odës së Inxhinerëve dhe të Odës së Arkitektëve, dhe kuadrit tjetër rregullativ të Odave, për çka edhe gjatë muajit Shkurt të vitit 2025 ka mbajtur trajnim për organet e Odës së Inxhinerëve dhe ato të Odës së Arkitektëve.